



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi/personi nën hetim **Blerim Xheka** me datë **19.12.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Konstatim i humbjes së fuqisë së paraburgimit për shkak të kalimit të afateve të kohëzgjatjes të paraburgimit për personin nën hetim Blerim Xheka, i arrestuar në dt. 25.04.2024, aktualisht nën efektet e masës së sigurimit personal “*arrest në burg*”, caktuar me vendimin nr. 44 dt. 27.04.2024 të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Çela, bazuar në nenet 112, 237, 263/1 shkronja “b” dhe 266 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. 740, datë 21.12.2024, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuesit (personit nën hetim) **Blerim Xheka**.
2. Konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit personal “*Arrest në burg*” e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, e caktuar ndaj kërkuesit (personit nën hetim) **Blerim Xheka** me vendimin Nr. 44, dt. 27.04.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar, për shkak të kalimit të kohëzgjatjes maksimale të afateve të masës së sigurimit sipas përcaktimeve të nenit 263/1 shkronja b) të K.Pr.Penale.
3. Caktimin ndaj shtetasit **Blerim Xheka**, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Kultivimi i bimëve narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 284/2 të K.Penal, të masës së sigurimit personal “*Arrest në shtëpi*” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.
4. Urdhërohet personi nën hetim **Blerim Xheka** që të mos largohet nga banesa e tij që ndodhet në ****.
5. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i personit nën hetim **Blerim Xheka** nga ambjentet e paraburgimit, nëse ai nuk mbahet i arrestuar me ndonjë masë tjetër sigurimi “*Arrest në burg*”, si i dyshuar për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale apo me ndonjë vendim dënimi me burgim.
6. Urdhërohet policia gjyqësore dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar për zbatimin e këtij vendimi.

7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brënda 5 ditëve, afat ky që fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

Tiranë, më datë 21.12.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar